



KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazna

Nr. VIII - 114  
Br.

Data 20.05.2020  
Datum

OBILIQ-OBILIC




Republika e Kosovës- Republika Kosovo- Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq



Drejtorija për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Mirotvorno  
Department for Health and Sociale Welfare

Datë:	20/05/2020
Për/Za/To:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal- Burim Gërguri
Përmes/Preko/Throuch	Kryetarit të Komunës- z.Xhafer Gashi
Nga /Od/From:	DSHMS- Vlora Kabashi
Tema/Subjekat/Subject:	Raport



Me 22.02.2020 në ora 20:58, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, ka kërkuar nga të gjithë drejtorët të institucioneve shëndetësore në Republikën e Kosovës në mënyre urgjente të sigurohen:

1. Identifikimin e objektit për karantinë të grupeve, pacienteve që janë të dyshimt me Corona Virus, me qëllim të mos përzierjes me pacientë të tjerë.
2. Sigurimi i paisjeve mbrojtëse për puntorët shëndetësorë të QKMF-ve.
3. Sigurimi i një e më shumë termometrave me rreze infra të kuqe.
4. Të gjitha QKMF-të të përditësojnë të dhënat dhe të raportojnë në detaje për të gjitha masat e ndërmarra.

Me 23.02.2020 Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHP ka kërkuar me prioritet nga Komunitat të caktojmë ekipe 24 orëshe të cilat nga data 24.02.2020 të bëjnë matjen e temperaturës të gjithë qytetarëve që kërkojnë shërbime shëndetësore në QKMF.

Poashtu është kërkuar që të caktohen ekipe mbështetëse në pikat kufitare, ku do të kontrollohen të gjithë pasagjeret në hyrje të kyfinjëve tokësorë të Kosovës për shenja klinike të Corona Virusit.

Duke u mbështet në rekomandimet dhe detyrat e dalura nga IKSHP dhe MSH, që nga data 24.02.2020, DSHMS-QKMF, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ku siguroi:

1. 3 termometra me rreze infra t'kuqe
2. maska, doreza dhe dezinfektues.
3. Identifikimi i objektit për ekzaminim të pacientëve të dyshimt- Njësia e Urgjencës caktohet si portë hyrëse për pacientët e dyshuar me Corona Virus.
4. Veshmbathje komplet me syza mbrojtëse ( të cilat komuna jonë i ka poseduar qysh moti dhe kemi qenë të gatshëm për të ndihmuar edhe komunat të cilat kanë pasur nevojë; Lipjanin, Drenasin, Prishtinën, Vitinë, Ferizajin dhe Pejën ).
5. Formuam ekipet për monitorimin e situatës, janë caktuar katër ekipe monitoruese.
6. U ngrit niveli i higjienës dhe masava tjera profilaktike në bazë rekomandimeve të IKSHP-Së : Dezinfektimi i QKMF-së dhe autoambulancave në baza ditore.
7. I gjithë personeli është i njoftuar me masa të cilat duhet të ndërmerrën në parandalimin e infeksionit me Corona Virus.
8. Kemi vendosur postere, njoftues, udhëzues mbi njohuritë për virusin në të gjitha Shkollat, Ambullanta, Shtëpi të Pleqve, Qendër për Punë Sociale, Qendra Rinore, Salla Sportive, Shtëpi të Kulturës, Qendrën për Punsim, Komunë etj.
9. Stafi administrativ dhe teknik angazhohen me punë të tjera si:
  - staf mbështetës për ekipe shëndetësore, vozitës etj.
10. Janë dediku autoambulanca dhe vetura vetëm për raste të dyshuara me virusin Corona.
11. U siguruan ekipe mbështetëse në Aeroportin e Prishtinës "ADEM JASHARI", të paisura me veshmbathje, termometra. Kryetari i Komunës siguroi mbështetje logjistike për këto ekipe (paisjet, veturën, ushqimin).
12. Paisen me mjete mbrojtëse të gjithë pacientët e Hemodializës.
13. Ndërpritën të gjitha pushimet vjetore për puntorët shëndetësorë.

Nga data 23.02.2020 është punu çdo ditë jave dhe takime të rregullta ditore me Kryetarin, DSHMS dhe QKMF.

Duke pas parasysh situatën epidemologjike e cila mernte përmasa më të mëdha si dhe fluksin e madhë të udhëtarëve të kthyer nga vatrat epidemike më 08.03.2020 nga MSH rekomandohet të dyfishohen ekipet e QKMF-ve në hyrjet kufitare të Kosovës, si dhe personat që vinë nga vatrat epidemologjike të vetëkarantinohen. Me këtë rast dyfishohen ekipet tona në Aeroport të Prishtinës ku dërgohet edhe epidemiologia e Komunës sonë. Gjithsej formohen tri ekipe mbështetëse nga Komuna e Obiliqit.

Sigurohen mjete mbrojtëse për personel nga Komuna e Obiliqit, konkretisht nga petty cash i DSHMS.

Me qëllim të menaxhimit të situatës dhe rrezikut të mundshëm nga Corona Virusi më 11.03.2020. në Komunën e Obiliqit mbyllet përkohësisht "Shtëpia e Pleqëve" si rezultat i rrezikshmërisë më të lartë që të moshuarit të atakohen nga Virusi Korona. Pas mbylljes së aktiviteteve në "Shtëpinë së Pleqëve" ky objekt caktohet si karantinë për rastet e infektuara me COVID-19.

Nga depo Qëndrore e Ministrisë së Shëndetësisë më 12.03.2020, paisemi me 80 veshëmbathje dhe 5 termometra me rreze infra të kuqe.

Formohen ekipe mobile që punojnë 12 orë, të paisura me mjete mbrojtëse për egzaminim të pacientëve të dyshimt.

Më 13.03.2020 formohet Shtabi Komunal Emergjent për kordinimin e aktiviteteve për parandalimin e COVID-19 në Komunën e Obiliqit.

Sigurohet dezinfektues, maska, doreza dhe termometra me rreze infra të kuqe për zyrën pritëse në Komunë, inspektorët komunal, zyrtarët e policisë, sigurimin.

Më 14.03.2020 nga donator të ndryshëm, siguroam 400maska dhe 2 termometra me rreze infra të kuqe.

Më 15.03.2020 me kërkesë të MSH u dërgu një ekip shëndetësore në mbështetje të kufirit në Elez Han. Ekipa shëndetësore nga Komuna e Obiliqit ekzaminoi mbi 100 të ardhur nga vatrat epidemiologjike.

Më kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, më 15.03.2020 Qeveria merr vendim me nr.01/11 të shpallë gjendje të emergjencës për shëndetin publik.

Më 15.03.2020 nga policia e Komunës sonë jemi njoftu për një të ardhur, shtetase italiane nga Venecia e punsuar në biznesin XX, të Komunës sonë. Ekipa shëndetësore takon

menjëher shtetasen italiane të cilës i bën ekzaminimin për shenjat e COVID-19.

E ardhura gjatë gjithë kohës kishte mbajtur maskë dhe doreza e cila nuk kishte shenja të virusit. Iu dhanë të gjitha rekomandimet e duhura, vetizolim në banesën të cilën jetonte, nënshkrimin e deklaratës se nuk do thente asnjë rekomandim as detyrë të vetëizolimit dhënë nga IKSHP-ja, numrin e telefonit.

Nga banorët e Komunës sonë me 15.03.2020 u njoftuam për një të kthyer në Komunën e Obiliqit. Personi XX kishte ardhur nga Bolzano e Italisë. Gjendja shëndetësore e të ardhurit ishte e qetë dhe stabile, nuk kishte shenja të virusit COVID-19.

I rekomanduam qëndrim në shtëpi deri në 14 ditë, morëm numrin kontaktues me të cilin do kontaktohet çdo ditë dhe do i jepen rekomandime në vazhdimi.

Më, 15.03.2020, rreth orës 21:00 rasti I konfirmuar nga IKSHP-ja, çifti I ardhur nga Londra që ka rezultuar pozitiv lëshohet nga Klinika Infektive për vetë izolim në Komunën tonë, duke mos informu Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Obiliq në mënyrë që ta siguronim transportin sipas rekomandimeve, po ashtu pa dijenin e Shtabit Emergjent Komunal apo Policinë.

Më, 15.03.2020, paisëm Stacionin e Policisë me një termometër me rreze infra të kuqe.

Më datë, 16.03.2020, morrëm informacion për një të ardhur nga Milano. Ekipa e QKMF-së vizitoi menjëherë familjen për egzaminimin e shenjave të virusit Corona. Familjes ju dhanë të gjitha rekomandimet dhe e udhëzuan për vetë izolim.

Me secilën familje të vetëizoluar në baza ditorë ka komunikuar Epidemiologjia e QKMF-Obiliq. Çdo ditë nga familjet janë marrë të dhëna për gjendjen e tyre shëndetësore dhe ju janë përsërit rekomandimet dhe përgjegjësitë e vetëizolimit në mënyrë që të shmangët përhapja e virusit COVID 19.

Më, 16.03.2020, furnizua zyrtarët komunal dhe inspektorët me mjete mbrojtëse si: Doreza, Maska dhe termometër me rreze infra të kuqe.

Në ora 12:49 më, 16.03.2020, u furnizua nga depo qendrore e MSH me material mbrojtës si: 300 Maska dhe 4000 Dorëza.

Më, 16.03.2020 dhe 17.03.2020 epidemiologjia së bashku me drejtorin e QKMF-së vizituan të gjitha qendrat e shërbimeve shëndetësore duke vëzhguar zbatimin e rekomandimeve dhe detyrave në lidhje me parandalimin e infeksionit me Covid-19.

Më, 17.03.2020, kontaktova me të gjithë Kryetarët e Këshillave të fshatrave dhe lagjeve për të verifikuar nëse ka të ardhur nga vendet e prekura me Covid-19.

Më, 17.03.2020, furnizohet me material mbrojtës zyrtarët komunal dhe inspeksioni.

Më, 17.03.2020 në ora 11:00, u takuam me Kolegjiumin e Shëndetësisë në Prishtinë, të gjithë drejtorët e DSHMS-ve paraqitën kërkesat urgjente si:

1. Kërkesë për furnizim me material mbrojtës në menyrë urgjente
2. Komunikim në baza ditore me nivelin qëndrorë
3. Kërkesë për furnizim me pako ushqimore për rastet sociale, rastet e izoluara në karantinë dhe ekipet kufitare.

Më, 17.03.2020, u vendos tenda në QKMF me qëllim të egzaminimit të rasteve të dyshuara me Covid-19.

Më, 17.03.2020, ekipa e QKMF dërgohet në Elez Hanë. Gjatë 12 orëve punë kontrolluan 150 persona të hyrë në Kosovë.

Në ora 13:00 më, 18.03.2020 ekipa Shëndetësore kontaktoi çiftin e prekur me Covid-19 ku e ndihmuan me ushqim si dhe pako higjienike, ju përsëritën rekomandimet e vetizolimit. Qifti i rezultuar pozitiv me COVID 19 deklaruan se janë mirë dhe nuk po i thejnë rregullat e vetë izolimit.

Më, 19.03.2020, në ora 9:03, vizituam banesat kolektive në Plemetim, ku biseduam me përfaqesin e tyre. Gjendja shëndetësore e tyre ishte e mirë dhe nuk kishte të ardhur nga vendet e tjera.

Në ora 10:00 vizituam ambullantën e Plemetinit ku doktori deklaroi se gjendja ishte e qetë dhe stabile, nuk ka të dyshuar apo të ardhur nga vendet e prekura me Covid-19.

Më, 19.03.2020 Bashkësia Islame bëri shpërndarjen e pakove higjienike në Plemetin, ata ndihmuan 60 familje në banesat kolektive, Plemetin, në lagjen Markovac- 10 familje, Obiliq- 9 familje, si dhe familje te ndryshme në Mazgit, Breznicë, Milloshevë dhe Kozaricë, gjithësej u ndihmuan 150 familje me mjete higjienike.

Më 19.03.2020 dy banorë nga Obiliqit me simptoma dyshimi. Rekomandohen vetizolim 14 ditë. Kontaktohen në baza ditore nga epidemiologia e QKMF.

Më, 20.03.2020, ekipa e QKMF nga ora 15:00 ishte në Aeroportin Adem Jashari për të kontrollu edhe 100 të ardhur nga Gjermania.

Më, 20.03.2020, në ora 14:52, u funizuam me Material mbrojtës nga MSH.

Më 20.03.2020 në ora 18:37, një e dyshuar me shenja të Covid-19 u dërgua në Klinikën Infektive për analiz, pas ekzaminimit rekomandohet për vetëizolim.

Dy raste në ora 23:30 me datë 20.03.2020, dërgohen nga ekipa e QKMF-së Obiliq, në Klinikën Infektive si raste të dyshuara me Covid-19. Të dy familjet pas ekzaminimit shkojnë në vetëizolim.

Të gjitha familjet e vetëizoluara janë kontaktu në baza ditore nga Epidemiologia jonë. Janë rekomandu për masat e vetëizolimit si dhe ju janë përsërit masat mbrojtëse të cilat duhen të ju përmbahen po ashtu të kërkojnë në mënyrë urgjente ndihmë mjekësore nëse kanë ndonjë shqetsim apo përkeqsim të gjendje shëndetësore. Po ashtu që nga rasti i parë i paraqitur pozitiv me COVID 19 është ofru mbështetje logjistike për të gjitha familjet e vetizoluara nga Kryetari i Komunës së Obiliqit.

Më 21.03. 2020, kryhet Dezinfektimi në Komunën e Obiliqit në këto objekte:

Dezinfektimi në Objektet e Institucioneve Komunale , Shkollore , Shëndetësore, Fetare dhe Kulture Sportive

NR	Objektet e Dizenfektuara në Komunën e Obiliqit	Data	Siperfaqja
1	Ekipa e Parë	Data	
2	Objekti I Komunës - QKRC	21.03.2020	
3	Gjimnazi "17 Shkurt"	21.03.2020	
4	SHM Teknike "Ismail Dumoshi"	21.03.2020	
5	Institucioni Parashkollorë	21.03.2020	
6	SHFMU "Ibrahim Rugova" Obiliq	21.03.2020	
7	SHFMU "Ibrahim Rugova" Mazgit I Ult	21.03.2020	
8	SHFMU "Ibrahim Rugova" Mazgit I lart	21.03.2020	
9	SHFMU "Pandeli Sotiri" Obiliq I Vjetër	21.03.2020	
10	SHFMU "Hasan Prishtina" Milloshevë	21.03.2020	
11	SHFMU "Hasan Prishtina" Raskovë	21.03.2020	
12	SHFMU Babimovc	21.03.2020	
13	SHFMU "Naim FRASHËRI" Breznci	21.03.2020	
14	SHFMU "Naim FRASHËRI" Kozaric	21.03.2020	
15	Xhamia Obiliq I Vjetër	21.03.2020	
16	Xhamia Mazgit I Ulët	21.03.2020	
17	Xhamia Llazarev	21.03.2020	
18	Xhamia Milloshevë	21.03.2020	
19	Xhamia Bakshi - Objekt për të pame	21.03.2020	
20	Xhamia Raskov - Objekt për të pame	21.03.2020	
21	Xhamia Babimovc - Objekt për të pame	21.03.2020	
22	Kisha Babimovc	21.03.2020	
23	Xhamia Breznic	21.03.2020	
24	Xhamia Kozaric	21.03.2020	
25	QMF - Milloshevë	21.03.2020	
26	AMF - Babimovc	21.03.2020	

27	AMF - Breznic	21.03.2020
28	Objekti - BU- Market HYRJA 1-2	21.03.2020
29	Objekti te KEDS	21.03.2020
30	Ndërtesa e Kuqe 1-2	21.03.2020
31	OBJEKTI I BARDH tek Aziz Zhilivoda	21.03.2020
32	Objekti te DBB	21.03.2020
33	Objekti tek Barakat	21.03.2020
34	Shtëpia e Kulturës “ Xhavit Haziri”	21.03.2020
35	Qendra sportive - “Adem Jashar”i	21.03.2020
36	Ekipa e dytë Obiliq	21.03.2020
37	QKMF - OBILIQ	
38	Kryqi I KUQ	21.03.2020
39	Qendra Rinore	21.03.2020
40	Handi Kosi	21.03.2020
41	Shtëpia e Penzionerave	21.03.2020
42	Qendra për Punësim	21.03.2020
43	QPS	21.03.2020
44	Stacioni Policor	21.03.2020
45	Banesat e Hades 1-2-3-4 -5	21.03.2020
46	Banesat D dh GJ 1-2	21.03.2020
47	Banesat Kolektive Plemetin	21.03.2020
48	Barakat e RAE	21.03.2020
49	Shtëpia e Kulturës	21.03.2020
50	Shkolla Fillore ” Pandeli Sotiri” Plemetin	21.03.2020
51	Shkolla Fillore - Tek Serbët	21.03.2020
52	QMF - Plemetin	21.03.2020
53	Xhamia	21.03.2020
54	Kisha Ortodokse - Plemetin	21.03.2020
55	Xhamia Hamidi	21.03.2020
56	Shkolla Fillore” Mixheni “ Siboc	21.03.2020
57	AMF - SIBOC	21.03.2020
58	Xhamia tek Mexhuanet	21.03.2020
59	Shkolla Fillore Graboc	21.03.2020
60	Xhamia Graboc	21.03.2020
61	Shkolla Fillore “Fazli Grajqevci” Hade	21.03.2020
62	Xhamia Hade	21.03.2020
63	Shkolla ” Fazli Grajqevci” Lajthisht	21.03.2020
64	Shkolla Fillore ” Fazli Grajqevci “ Palaj	21.03.2020
65	Xhamia - Lajthisht - Objekt për të pame	21.03.2020

Më 23.03.2020, Kryqi i Kuq vendor në bashkëpunim me UNICEF dhe DSHMS, ka shpërnda 70 pako higjienike për komunitetet e cënueshme RAE, në ndërtesat kolektive në Plemetin si dhe familjet e vendosura në barakat e Plemetinit.

Më 24.03.2020, DSHMS, QPS dhe Kryqi i Kuq shpërndanë 200 pako ushqimore për 200 familje, ku vlera e pakos ishte 50€, donacion ky nga Viva Fresh store dhe Buqajt. Prioritet ishin familjet e kategorisë së parë dhe nënat vetëushqyese.

Më 24.03.2020 në ora 16:30 u mbajt takim me Këshillin Emergjent Komunal. Kryetari i Këshillit Emergjent njiherit Kryetari i Komunës së Obiliqit kërkoj të ndahen mjete për furnizim me pako ushqimore për 1200 familje, mjete për dezinfektimin e objekteve në mënyrë të vazhdueshme si dhe sigurimin e mjeteve mbrojtëse për ekipet shëndetësore në Komunën e Obiliqit.

Me aprovimin e pjesëtarve të Shtabit Emergjent Komunal si dhe me aprovimin e Asambleistëve Komunal u ndanë mjete në vlerë prej 100,000.00€.

Këto mjete u dedikuan për:

60,000.00€ Ndihmë në pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë. Vlera e pakos 50€.

25,000.00€ Dezinfektim i objekteve publike dhe të tjera..

15,000.00€ Mjete mbrojtëse dhe paisje shëndetësore për personel.

I gjithë Shtabi Emergjent si dhe deputetet e Kuvendit Komunal në seancën e jashtëzakonshme u furnizuan me material mbrojtës.

Më 24.03.2020, organizata Rahmeti në bashkëpunim me DSHMS, ka shpërnda nga 25kg miell dhe 10kg patate për 110 familje të Komunitetit RAE në Komunën e Obiliqit.

Në baza ditore u bë dezinfektimi me klor i QKMF-ve, QMF, AMF dhe autoambulancave.

Më 25.03.2020, u furnizua me 100 mantil mbrojtës për një përdorim nga donator të Komunës sonë.

Më 26.03.2020, UNICEF bën shpërndarjen e 170 pakove higjienike për komunitetin RAE në Obiliq, te azotiku, elektrobartja, në banesat kolektive në Plemetin, barakat e Plemetinit dhe te kontinjerat. Vlera e pakos 20€.

Më 26.03.2020 me 200 pako higjienike u mbështetën familjet në nevojë nga UNDP dhe UNICEF.

Më 26.03.2020 një i dyshuar me simptoma të infeksionit me COVID 19. Pas ekzaminimit në Klinikën Infektive i dyshuari rekomandohet në vetizolim 14 ditë.



Më 27.03.2020 Ballkan Sunflowers bën shpërndarjen e 130 pakove ushqimore dhe higjienike. Vlera e pakos 20€.

IOM mbështet 10 familje nga të kthyerit në Komunën e Obiliqit, 9 familje të komunitetit RAE dhe 1 nënë vetë ushqyese e komunitetit serb. Vlera e pakos varet nga antarët e familjes, fillon nga 200€ e deri në 500€.

Ministria e Kthimit shpërndan pako ushqimore dhe higjienike për 20 familje sociale të komunitetit serb. Vlera e pakos 20€.

Më 28.03.2020, Bashkësia Islame në bashkëpunim me DSHMS, ndan nga 50kg miell për familjet e komunitetit RAE, të Komunës së Obiliqit.

Më 29.03.2020 u shpërndan 150 pako ushqimore dhe higjienike si dhe 25kg miell nga Bashkësia Islame dhe Duarte e Bamirsisë, vlera e pakos 50€.

Më 30.03.2020 nga depo qendrore u furnizuar me material mbrojtës kundër COVID-19.

Më 31.03.2020 filloi shpërndarja e 1200 pakove ushqimore dhe higjienike nga Komuna e Obiliqit për familjet në nevojë. Vetëm mbrenda kësaj dite janë shpërndarë 376 pako ushqimore dhe higjienike. Vlera e pakos 50€.

Mjete mbrojtëse kundër COVID -19 për stafin shëndetësorë, më 31.04.2020 siguroam nga Drejtori i Kekut Luigj Imeri në vlerë prej 600€.

Më 01.04.2020 çifti i ardhur nga Londra i rezultuar pozitiv me COVID-19, dërgohet për rritestim i cili pas rritestimit të parë rezultoi negativ.

Me kërkesë të MSH dhe Prokurorisë, një ekipë shëndetësore nga QKMF-Obiliq dërgohet më 02.04.2020 në përcjellje të policisë të transportojë dy shtetas të huaj nga karantinimi në Vranidolli për në Leposaviq- Jarinjë.

Më 03.04.2020 një banorë e Komunës së Obiliqit së bashku me fëmijët pas ekzaminimit shkojnë në vetizolim.

Më 03.04.2020 furnizuar Stacionin e Policisë në Obiliq me mjete mbrojtëse.

Shtëpinë e çiftit e dezinfektuar më 03.04.2020 ku po në këtë datë çifti rezultoi negativ për herë të dytë pas rritestimit të bërë në Klinikën Infektive.

Kryqi i Kuq siguroi 70 pako higjienike për familjet në nevojë. Vlera e pakos 20€.

Më 06.04.2020, dy banorë të Komunës së Obiliqit me simptoma të infeksionit COVID 19 shkojnë në vetizolim.

Më 07.04.2020 u furnizuar me mjete mbrojtëse nga depo qendrore.

Më 08.04.2020 filloi të bëhet Dezinfektimi për herë të dytë në objektet Komunale, Shëndetësore, Banesat Kolektive, QPS, Shtëpinë e çiftit të rezultuar negativ pas riestimit të bërë, shtëpinë e Nazmi Dedincës, dy objektet e OJQ Ballkan Sunflowers, Shtëpinë e Kulturës në Milloshevë, Shtëpinë e Pensionerave- ish Ambullantën në Milloshevë. Mjetet e këtijë projekti janë nga shuma e ndarë nga Kuvendi Komunal Obiliq me datë 24.03.2020, kontratë e lidhur më 03.04.2020 në vlerë prej 24,500.00€ .

Më 09.04.2020 një donatorë nga Prishtina ndihmon 4 familje në nevojë. Vlera e pakos 50€.

Më 10.04.2020 bashkëatdhetari ynë Preniqi nga Gjermania dhuron 20 pako për familjet në nevojë. Vlera e pakos 50€

Më 13.04.2020 Halil Kastrati, Jetimat e Ballkanit dhuruan 200 pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë të Komunës sonë. Vlera e pakos 50€.

Më 14.04.2020 një banorë i Komunës së Obiliqit pas testimit të bërë rezulton negativ. Rekomandohet vetizolim për 14 ditë.

Më 15.04.2020 Vëllezërit Mjeku nga Komuna e Obiliqit dhuruan 13 pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë.

Furnizua me mjete mbrojtëse zyrtarët komunal, ekipet të cilat punonin në teren, stafin e Qendrës për Punë Sociale dhe policinë.

Më 16.04.2020 në Qendrën për Punë Sociale filloi aplikimi për pakon fiskale, masa 15 në vlerë prej 130€. Aplikuesit mundë të aplikojnë në mënyrë fizike dhe online. Kjo pako fiskale masa 15 vlenë vetëm për ato familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar as nuk përfitojnë nga asistenca sociale.

Më 17.04.2020 kemi edhe disa raste me simptome dyshimi të cilat janë kontaktuar për të marr të dhëna epidemilogjike për sëmundjen Covid-19, të cilat raste janë në observim të vazhdueshëm.

Të gjitha rastet kontaktohen me telefon për masat që duhet zbatuar (vetizolim 14 ditë) njësia policore po ashtu i ka të gjitha të dhënat e tyre.

Më 17.04.2020 bashkëatdhetari ynë Mirena nga fshati Hade dhuroi 20 pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë. Vlera e pakos 50€.

Më datën 19/04/2020 vizitua banorët e komunitetit RAE që jetojnë në ndërtesat sociale në Plemetin ku për së afërmi I njoftua dhe kshilla për të disatën herë rreth sëmundjes së Covid-19 si dhe për masat mbrojtëse kundër kësaj sëmundje të rekomanduara nga IKSH, MSH, OBSH si dhe ju shperndanë barna të semurëve kronik.

Insulin varësit u furnizuan me insulina në shtëpit e tyre nga ekipet shëndetësore.

Më 19.04.2020 banor nga Obiliqi, rezulton negative pas testimit, gjendja stabile. Rekomandohet vetizolim 14 ditë.

Më 20.04.2020 në Komunën e Obiliqit po vazhdon Dezinfektimi i objekteve për herë të tretë. U dezinfektuan objektet Shëndetësore dhe të gjitha autoambulancat, Komuna, QKRC, Stacioni Policor dhe veturat e tyre zyrtare, QPS, Enti i Punsimit, Banesat Kolektive në Plemetin dhe Obiliq, Barakat në Plemetin. Mjetet e këtijë projekti janë nga shuma e ndarë nga Kuvendi Komunal Obiliq me datë 24.03.2020, kontratë e lidhur më 03.04.2020 në vlerë prej 24,500.00€ .

Më 21.04.2020 një bashkëatdhetar nga Londra dhuron 10 pako ushqimore për familjet në nevojë. Vlera e pakos 50€.

Më 22.04.2020 familja Preniqi nga fshati Hade dhuron 1000kg miell për familjet në nevojë. Vlera e pakos 50€.

Më 23.04.2020 Kryetari i Komunës dhuron 33 pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë. Vlera e pakos 50€.

Më 24.04.2020 u furnizuan me:

1	Alcohol 96%	litër	199
2	Dorza josterile 1x100 Medium	copë	3000
3	Maska kirurgjikale	copë	7000
4	Uniforma mbrojtëse komplet	copë	400

“Mjetet mbrojtëse për personel” është projekt i vendimit me nr.I- 40 të datës 24.03.2020 nga Kuvendi Komunal Obiliq në vlerë prej 15,000.00€. Kontrata është lidhur më 23.04.2020 në vlerë prej 13,686.01€.

Më 24.04.2020 me kërkesë të MSH, ekipet shëndetësore nga Komuna e Obiliqit vazhdojnë punën në Aeroportin e Prishtinës “Adem Jashari”, për kontrollimin e pasagjerve. Dy ekipe shëndetësore do jenë në Aeroportin e Prishtinës çdo të tretën ditë.

Më 24.04.2020 një i karantinuar në Qendrën e Studentëve nga Komuna e Obiliqit, pas testimit rezulton negativ.

Më 27.04.2020 u bë shpërndarja e 127 pako ushqimore dhe higjienike për komunitetin RAE në Plemetin nga OJQ Ballkan Sunflowers. U ndihmuan edhe 40 fëmijë me pako shkollore të po këtijë komuniteti.

Nga USAID u furnizua me 200 pako higjienike për familjet në nevojë . vlera e pakos 20€.

Më 29.04.2020 IOM bëri shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për 29 familje të komunitetit RAE, 1 boshnjak dhe një serbe. Vlera e pakos është mbi 300€ varsisht nga antarë e familjes dhe është pako tremujore.

Më 30.04.2020 Relief Islamik mbështeti familjet në nevojë me 100 pako ushqimore. Vlera e pakos 20€.

Më 01.05.2020 testohet një banorë i Obiliqit. Pas testimit në Klinikën në Klinikën Infektive i dyshuari rezulton negativ.

Më 02.05.2020 një i dyshuar me infeksion COVID 19 rezulton negativ.

Me datën 03/05/2020 UNICEF vendos një tendë në oborrin e QKMF-Obiliq me hapsir prej 30m<sup>2</sup>.

Me datën 04/05/2020 fillon punën shërbimi i vaksinimit për fëmijët. Vaksinimi do bëhet në objektin ndihmës të ndarë nga mjekësia familjare sipas rekomandimeve të IKSHPK ku janë njoftu të gjithë prinderit përmes mesazheve televizive, rrjeteve sociale, thirrjes telefonike. Me datë 04/05/2020 fillon vaksinimi i rregullt për fëmijet e grup moshave të caktuara prej 2 muaj deri 18 muaj kurse vaksinimi i nxënësve të klasave të I,VI dhe XII është kryer për vitin shkollor 2019/2020 në të gjitha shkollat e Komunës së Obiliqit. Masat e ndërmarra nga shërbimi i vaksinimit, këshilla për vaksinim, COVID-19, mbajtja e distancës së prindërve, mbajtja e maskave, lejimi i vetëm njërit prind në vaksinim, matja e temperaturës fëmijut, nënës, dhënja lifletave për COVID-19 të dizajnuara nga UNICEF.

Më 04.05.2020 një banor i dyshuar me COVID 19 rezulton negativ pas testimit.

Më 05.05.2020 tri ekipe shëndetësore nga Komuna e Obiliqit mbështetën Aeroportin e Prishtinës “Adem Jashari” në kontrollimin e 150 pasagjerëve të ardhur nga shtetet Skandinave.

Më 07.05.2020 ekipa shëndetësore bëri transportimin e një banori të Obiliqit në shtëpinë e tijë nga karantinimi në Qendrën e Studentëve Prishtinë.

Më 07.05.2020 Fondacioni “Freskia” ndihmon Komunën e Obiliqit me 500 maska të punuara nga nënat vetëushqyese.

Më 07.05.2020 vendosëm dy Tunele, Porta Dezinfektuese në Komunën tonë. Njëra Portë u vendos në QKMF e tjetra në Sheshin e qytetit.

Më 08.05.2020 AQH e mbështetur nga Agjencia Zvicërrane për Bashkëpunim (SDC) mbështet familjet në nevojë me 158 pako ushqimore dhe 158 pako higjienike, gjithsej 316 pako. Vlera e njerës pako është 20 €.

Më 09.05.2020 u bë Dezinfektimi për herë të 4 në Komunën e Obiliqit.

U Dezinfektuan të gjitha objektet Shëndetësore, Autoambulancat, Komuna, QKRC, Stacioni I Policisë, veturat zyrtare të policisë, QPS, të gjitha Banesat Kolektive në Plemetin dhe Obiliq, Barakat në Plemetinë, Qendra e Punsimit.

Mjetet për këtë projekt janë ndarë nga Kuvendi Komunal Obiliq i vendimit me nr. I-40 të datës 24.03.2020, kontratë e lidhur më 03.04.2020 në vlerë prej 24,500.00€ .

Më 09.05.2020 u konfirmu rasti i parë i infektuar me COVID-19 në Komunën e Obiliqit. E infektuara ishte puntore-infermiere e Spitalit privat në Prishtinë.

Më 10.05.2020 u testuan 4 antarët e ngushtë të të infektuarës. Pas testimit të bërë në Klinikën Infektive të gjithë rezultuan negativ. Rekomandohet familja të vetëizolohet dhe pas 14 dite do të ritestohen prap.

Më 11.05.2020 UNICEF mbështet QKMF në Obiliq, QMF në Milloshevë dhe QMF në Plemetin me nga një pako të madhe higjienike. Vlera e pakos 100€.

Mbështetën po ashtu programin “vizitat shtëpiake për nënën dhe fëmijun deri në moshën 3 vjeçare” me 40 pako higjienike për familje dhe 40 pako higjienike fëmijëve. Vlera e pakos 50€.

Më 12.05.2020 Shtetet e Bashkuara Arabe mbështesin me 150 pako familjet në nevojë të Komunës së Obiliqit. Vlera e pakos 50€.

Më 12.05.2020 u testuan në Klinikën Infektive edhe 4 persona të familjes të të infektues me COVID 19 me datën 09.05.2020. Pas testit të bërë të gjithë rezultuan negativ. Rekomandohen të vetëizolohen për 14 ditë.

Më 14.05.2020 me kërkesë të MSH, MAPL, caktohet një zyrtare (gjinisë femrore) nga Qendra për Punë Sociale të kujdestarorje në Qendrën e Studentëve për trajtimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje ku një pjesë e Qendrës së Studentëve është siguru nga MSH për karantinimin e viktimave të dhunës në familje.

**ORARI I PUNËS PËR PUNËTORËT SOCIAL PËR MENAXHIMIN E RASTEVE  
TË VDHF NË QS KARANTINË, PRISHTINË  
16-22 Maj 2020**

<b>FËT E VËS</b>	<b>E SHTUNË 16.05.2020</b>	<b>E DIELE 17.05.2020</b>	<b>E HËNË 18.05.2020</b>	<b>E MARTË 19.05.2020</b>	<b>E MËRKURË 20.05.2020</b>	<b>E ENJTE 21.05.2020</b>	<b>E PREMTE 22.05.2020</b>
<b>OMUNA/ S</b>	FUSHË KOSOVË	OBILIQ	LIPJAN	PODUJEVË	PRISHTINË	SHTIME	GLLOGOC
<b>CIALE</b>	FLORIJE KASTRA TI	SHQIPE MORINA	FJOLLA IBRAHIMI	SELVETE SHABANI	ELHAME HAJDARI	FILLORETA ISUFI	FILLORETA HAJDARI
<b>ONTAKT</b>							
<b>LARI I NËS</b>	08:00-16:00	08:00-16:00	08:00-16:00	08:00-16:00	08:00-16:00	08:00-16:00	08:00-16:00

**KUJDESTARIA PAS ORËS 16:00 MBULOHEK NGA PUNËTORI SOCIAL KUJDESTAR NGA QPS PRISHTINË,  
NUMRIN KONTAKTUES KUJDESTAR**

Më 15.05.2020 me kërkesë të MSH, në ora 22:00, dërgohet një ekipë shëndetësore për kontrollimin e pasagjerëve në Aeroportin e Prishtinës “Adem Jashari”.

Më 15.05.2020 përfundon aplikimi për pakon fiskale Masa15. Në Komunën e Obiliqit deri më 16.05.2020 kanë apliku gjithsej 808 aplikant. 643 veta kanë apliku në mënyrë fizike dhe 165online. Faza e parë dhe e dytë e aplikimit ka përfunduar me sukses. Pesë zyrtarët e QPS kanë punu në vazhdimsi, çdo ditë pune.

Më 16.05.2020 UN, mbështet familjet në nevojë me 50 pako ushqimore dhe 40 pako higjienike, gjithsej 90 pako. Vlera e pakos është 50€.

Më 17.05.2020 testohet edhe një banorë nga Komuna e Obiliqit. Pas testimit në Klinikën Infektive i dyshuari rezulton negativ.

Më 18.05.2020 “Risi Com” Obiliq, mbështet me 50 pako ushqimore familjet në nevojë. Vlera e pakos 50€.

Më 18.05.2020 u ndihmuan 40 familje të komunitetit RAE në Plemetin. Pakot ushqimore dhe higjienike u siguruan nga OJQ ”ROMACTED”.

Situata epidemiologjike me Covid-19 ne Komunën e Obiliqit është e qetë, gjatë periudhës prej lajmërimit të parë në Kosovë me Covid-19 në Komunën tonë vetëm 2 raste janë pozitive kurse të gjitha rastet tjera kanë rezultuar negative (25 raste të testuara negative). Rekomandimet dhe masat mbrojtëse nga IKSHPK, MSH janë duke u respektu të gjitha.

Me respekt!